

Olimpi

NUMËR 14 | 2023



KOSOVO



ARRITJE HISTORIKE

KOSOVA MIKPRITËSE E
LOJËRAVE MESDHETARE **PRISHTINA 2030**

KOSOVA, HOST OF THE
PRISHTINA 2030 MEDITERRANEAN GAMES



XXI MEDITERRANEAN GAMES
HOST CITY

PRISHTINA 2030



**253 MLN. €
INVESTIME**

KOK-ut I BESOHE T ORGANIZIMI I PLATFORMËS EVROPIANE TË SPORTIT 2024





Olimpi - 2023

Përgatiti: Kushtrim Krasniqi
Fotot/Photos: Shpend Ahmeti,
Fotot tjera/Other photos: Facebook
Përkthimi/Translated: Translation Center

BOTIMI:
Komiteti Olimpik i Kosovës/Kosovo Olympic Committee
ADRESA: Rruga Agim Ramadani,
Nr. 253, Kati i Parë, 10 000 Prishtinë

www.noc-kosovo.org

RRJETET SOCIALE:
<https://www.facebook.com/kosvoolympiccommittee/>
<https://www.instagram.com/kosvoolympiccommittee/>
<https://twitter.com/NOCKOSOVO>
https://www.youtube.com/channel/UCdU002ZSh8bs_mnGzv8fdKg
<https://www.linkedin.com/kosvoolympiccommittee>
<https://www.tiktok.com/kosvoolympiccommittee>

DIZAJNI: Florent Gashi
SHTYPI: Shtypshkronja Blendi

PËRMBAJTJA

10

Majlinda Kelmendi kërkon që medaljet e arta t'i mbajmë në Kosovë

19

Lojërat e para Evropiane, pa medalje për ekipin tonë

22-23

EOC nderon drejtuesit e KOK-ut

24-25

KOK dhe BKT Kosova nënshkruajnë kontratë sponsorizimi në vlerë 3 mln. Euro për 10 vite

24-25

Lojërat Mesdhetare u diskutuan në "Forum in për Sportin"

24-25

KOK nga viti 2024 ofron studime në programin e edukimit "Trajner Sportiv"

24-25

Katër medalje evropiane për ekipin e xhudos

KOSOVO



Arritje historike!

8 shtatori 2023 ka hyrë në njërin prej datave më historike për sportin e Kosovës dhe vetë shtetin tonë.

Ajo çfarë ndodhi në Heraklion të Kretës së Greqisë do të kujtohet gjatë, aq gjatë sa sportistët tanë, rinia jonë dhe gjithë populli i Kosovës do t'ia shohin hajrin për dekada të tëra, pasi përfitimet do të jenë të mëdha, shumë të mëdha.



Ndoshta, dikujt mund t'i duket e lehtë marrja e një organizimi të tillë, por ka një vit që jemi përballur me sfida të ndryshme për ta përjetuar këtë moment.

Sfidat me të mëdha ishin mungesa e detit, e cila na penalizonte në statutin e ICMG-se, dhe që fillimisht duhej ndryshuar kjo pikë e statutit. Pastaj mungesa e infrastrukturës, për të cilën megjithatë kemi marrë raport pozitiv, falë edhe investimeve që janë planifikuar të bëhen nga Qeveria e Kosovës.

Sfidë e madhe, dhe e pritshme, sidomos muajve të fundit, ishte ofensiva e jashtëzakonshme e Serbisë, e cila me të gjitha forcat tentonte ta parandalonte kandidaturën tonë, duke bërë kërkesa të ndryshme, të cilat u panë edhe gjatë Asamblesë së Përgjithshme të ICMG.

Natyrisht, pa marrëdhëniet e shkëlqyera që kemi krijuar, me pothuajse të gjitha Komitetet Olimpikë Kombëtare, pa lobimin e madh tonin si Komitet Olimpik, 55 votat e marra nga 66 asambleistë, ku vetëm 8 ishin kundër, fitorja jonë për mikpritjen e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, nuk do të ishte kaq bindëse.

Falënderim pa fund për BE të KOK-ut, Qeverisë tonë me kryeministrin Albin Kurti, MKRS-në me ministrin Hajrullah Çeku dhe ministrit tjera përkatëse, komunës së Prishtinës, me në krye Përparim Ramën dhe komunave tjera bashkëpunuese, Qeverisë shqiptare, KOKSH-it me mikun tim Fidel Ylli, etj.

Edhe një herë, urime dhe na priftë e mbara së bashku!

Ismet Krasniqi
President i KOK-ut

A historic achievement!

September 8, 2023, will be remembered as a major milestones for Kosovo sports and our country itself.

What happened in Heraklion, Greece, will echo for a long time, as our athletes, our youth, and all Kosovo people, will enjoy its benefits for decades to come, as the benefits will be great.

Perhaps, one may think it is easy to host such an event, but for an entire year we had to face various challenges to experience this moment.

The first major challenge was the lack of sea, which penalized us in the ICMG charter, and this point of the charter had to be changed first, followed by the lack of infrastructure, on which we received a positive report, thanks to the investments planned to be made by the Government of Kosovo.

Another major but expected challenge, especially in recent months, was Serbia's extraordinary offensive, which did its best to prevent our candidacy, making various demands, which were also seen during the ICMG General Assembly.

Obviously, without the excellent relations we have established with almost all National Olympic Committees, without our great lobbying as National Olympic Committee, the 55 votes for and only 8 against received from the ICMG Assembly, our winning bid to host the Mediterranean Games Prishtina 2030, would not have been so convincing.

I wish to express my endless gratitude to NOC-Kosovo's Executive Board, to our Government and Prime Minister Albin Kurti, the Ministry of Culture and Minister Hajrullah Çeku and other relevant ministers, the municipality of Prishtina and mayor Përparim Rama, and other cooperating municipalities, and to the Albanian Government, NOC-Albania and my friend Fidel Ylli, etc. Once again, congratulations and all the best to everyone!

Ismet Krasniqi
NOC Kosovo President

KALENDARI I LOJËRAVE TË ARDHSHME



Lojërat Olimpikë Dimërore për të Rinj Gangwon 2024/Gangwon 2024 Winter Youth Olympic Games

19.01.2024 - 01.02.2024



Lojërat Olimpikë Paris 2024/Paris 2024 Olympic Games

26.07.2024 - 11.08.2024



Festivali Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj Bakuriani 2025/European Youth Winter Olympic Festival Bakuriani 2025

Janar 2025/January 2025



HISTORIKE: Kosova, organizatore e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030

8 shtator 2023 - Kosovës i është besohet organizimi i Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), ka votuar pro kandidaturës Prishtina 2030.

55 vota pro, 8 kundër dhe tri vota të pavlefshme ishte bilanci i fitores së madhe të Kosovës, ku delegatët e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Ismet Krasniqi, sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti dhe nënpresidenti, Milaim Kelmendi, nuk kishin të drejtë vote, sikurse delegatët e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, presidenti Fidel Ylli dhe sekretari i përgjithshëm, Gerti Shima.

Shqipëria do të jetë bashkëorganizatore, pasi sporti i lundrimit do të zhvillohet në bregdetin shqiptar.

Pavarësisht se Kosova ishte kandidatja e vetme, procesi nuk ishte aspak i lehtë, marrë parasysh kundërshtimin e madh të Serbisë, delegati i së cilës kërkonte të hidhej në votim shtyrja e zgjedhjes së vendit mikpritës deri pas Lojërave Olimpik Paris 2024, propozim që sipas drejtuesve të ICMG-së është në kundërshtim me statutin e ICMG-së, pasi një propozim i tillë për ndryshim të rendit të ditës do të duhej të vinte muaj më parë.

Paraprakisht, një tjetër sfidë ishte edhe ndryshimet në statut, të cilat ua mundësuan edhe vendeve pa bregdet të organizojnë Lojërat Mesdhetare, që njëherit ia hapi rrugën pikës së fundit të rendit të ditës, e ku ishte kandidatura Prishtina 2030.

Në Asamble, të mbajtur në Heraklion të Greqisë, të pranishëm ishin edhe udhëheqësit e shtetit me kryeministrin Albin Kurti, ministrat Hajrullah Çeku (MKRS), Hekuran Murati (MF), Elbert Krasniqi (MAPL), kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, drejtuesit e KOK-ut, si dhe drejtori i BKT Kosova, Suat Bakal.

Kryeministri Kurti, presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ai i KOKSH-it, Fidel Ylli, në fjalën e tyre folën për rëndësinë që ka një organizim i tillë për zhvillimin e sportit tonë dhe përfitimet të cilat do t'i fitonte shteti ynë. Pas fitores, ata e quajtën arritje të jashtëzakonshme për shtetin tonë.

Sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, bëri një prezantim se si do të dukeshin këto Lojëra në Kosovë, ndërsa opinion tejet pozitiv dha edhe udhëheqësi i komisionit vlerësues të ICMG-së, të cilët vizituan vendin tonë në muajin korrik 2023.

Pas deklarimit të fitores, u nënshkrua edhe kontrata mes drejtuesve të ICMG-së, KOK-ut, Prishtinës dhe ministrive përkatëse.

Prishtina u bë qyteti i parë jo bregdetar që do të organizojë Lojërat Mesdhetare.

55 vota pro, 8 kundër dhe tri vota të pavlefshme ishte bilanci i fitores së madhe të Kosovës



HISTORICAL: Kosovo, host of the 2030 Prishtina Mediterranean Games

September 8, 2023 - Kosovo has been entrusted with hosting the 2030 Prishtina Mediterranean Games. The General Assembly of the International Committee of Mediterranean Games (ICMG) voted in favor of the Prishtina 2030 bid.

The vote count was 55 in favor, 8 against, and 3 invalid votes, marking a major victory for Kosovo. Delegates from the Kosovo Olympic Committee did not have voting rights, similar to delegates from the Albanian National Olympic Committee. Albania will be a co-host since sailing competitions will take place on the Albanian coast.

Despite Kosovo being the only bidder, the process was not easy at all, given the strong opposition from Serbia. The Serbian delegate sought a vote on postponing the host city election until after the 2024 Paris Olympics, a proposal that according to ICMG leaders violates the ICMG statute since such a proposal to change the agenda should have come months in advance. Previously, another challenge was the amendments to the statute which enabled non-coastal countries to host the Mediterranean Games, paving the way for the final agenda item - the Prishtina 2030 bid.

The Assembly, held in Heraklion, Greece, was attended by state leaders including Prime Minister Albin Kurti, Ministers Hajrullah Çeku (MCYS), Hekuran Murati (MoF), Elbert Krasniqi (MLGA); the Mayor of Prishtina, Përparim Rama; the leadership of the Kosovo Olympic Committee; and the CEO of BKT Kosovo, Suat Bakkal.

In their speeches, Prime Minister Kurti, the President of the Kosovo Olympic Committee Ismet Krasniqi, and the President of the Albanian National Olympic Committee Fidel Ylli spoke about the importance of such an event for the development of Kosovar sports and the benefits it would bring to our country. After the victory, they called it an extraordinary achievement for our country. The Secretary General, Besim Aliti, presented what these Games would look like in Kosovo, while the head of the ICMG evaluation commission, who visited our country in July 2023 gave a very positive opinion.

After declaring victory, a contract was also signed between ICMG leaders, the Kosovo Olympic Committee, the Municipality of Prishtina, and the relevant ministries.

Prishtina became the first non-coastal city to host the Mediterranean Games.





Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministaro Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

253 mln. euro investime

253 milionë euro është shuma që do të investojë Qeveria e Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

Gjatë prezantimit të konceptit të organizimit të LM Prishtina 2030, ministri për Kulturë, Rini e Sport, Hajrullah Çeku, theksoi se kjo shumë edhe mund të rritet.

Ai e quajti historike marrjen e këtij organizimi, dhe se LM do të shtrihet në shtatë komuna të Kosovës.

"Nëse e krahasojmë madhësinë e vendit, atë që jemi ne, numrin e popullatës, zhvillimin e gjithmbarshëm, Lojërat Mesdhetare për Kosovën janë si Lojërat Olimpike për Francën", u shpreh ministri Çeku.

Ai shtoi se 19 komuna në Kosovë do të shndërrohen në qendra të mëdha sportive dhe se ato do të jenë përfutuese të investimeve në infrastrukturën sportive ku do të përfshihen ndërtimi dhe renovimi i 24 objekteve sportive, duke përfshirë edhe ndërtimin e stadiumit nacional.

Çeku bëri të ditur gjithashtu se për organizimin e Lojërave Mesdhetare do të hartohet një ligj i veçantë në Kuvendin e Kosovës, e po ashtu do të krijohet një mekanizëm i cili do ta bëjë studimin e fizibilitetit për ndërtimin e infrastrukturës sportive ku janë të parapara që të investohen mbi 250 milionë euro deri në vitin 2030.



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sport

24 objekte sportive ndërtohen ose rinovohen

Sipas ministrit Çeku, 24 objekte sportive do të ndërtohen ose rinovohen për LM Prishtina 2030.

Ndër më të mëdhatë do të jenë stadiumi nacional dhe pishinat olimpike, por gjithashtu edhe renovimi i Palestrave sportive, përfshirë sallën e madhe të Pallatit të Rinisë dhe Sportit në Prishtinë.

Po ashtu, do të ndërtohen objekte tjera sportive për sportet tjera, si dhe renovimi i Qendrës së Studentëve, që do të shërbejë si Fshati Mesdhetar Prishtina 2030.



€253 Million Investments

€253 million is the amount the Government of Kosovo will invest for organizing the 2030 Prishtina Mediterranean Games. During the presentation of the concept for organizing the 2030 Prishtina Mediterranean Games, the Minister of Culture, Youth and Sports, Hajrullah Çeku, emphasized that this amount could even increase.

"If we compare the size of the country, what we are, the population number, overall development, for Kosovo the Mediterranean Games are like the Olympic Games for France," stated Minister Çeku.

He added that 19 municipalities in Kosovo will turn into major sports centers and they will benefit from investments in sports infrastructure including construction and renovation of 24 sports facilities, including building the national stadium.

Çeku also announced that a special law will be drafted in the Kosovo Assembly for organizing the Mediterranean Games, and a mechanism will also be created which will conduct a feasibility study on building sports infrastructure where over €250 million are planned to be invested by 2030.

24 Sports Facilities Constructed or Renovated

According to Minister Çeku, 24 sports facilities will be built or renovated for the Prishtina 2030 Mediterranean Games.

Among the largest will be the national stadium and Olympic swimming pools, but also the renovation of sports facilities, including the main hall of the Youth and Sports Palace in Prishtina. Other sports facilities for various other sports will also be built, in addition to renovating the Student Center which will serve as the Prishtina 2030 Mediterranean Village.



Lajm i madh për Kosovën dhe arritje e jashtëzakonshme!

Ja dolëm! Faleminderit shumë. Ky është një lajm i madh për Kosovën dhe një arritje e jashtëzakonshme për të gjithë.

Shpreh mirënjohjen time të përzemërt për të gjithë ata që kanë mbështetur vizionin tonë për të ardhmen e vendit dhe të gjithë rajonit të Mesdheut

E vlerësojmë me gjithë zemër mundësinë që na është dhënë që të bëjmë bashkë në vendin tonë, në Kosovë 26 shtetet anëtare nga tre kontinentet.

Ky rast është një simbol i shquar i përkushtimit tonë për të krijuar një të ardhme më të mirë, ku e kaluara nderohet, e tashmja festohet dhe e ardhmja formësohet nga një ndjenjë e thellë bashkimi.

Teksa nisim këtë rrugëtim drejt Prishtinës 2030, më lejoni t'i uroj të gjithë në Kosovë, veçanërisht sportistët tanë dhe komunitetin tonë sportiv. Kjo arritje është rezultat i punës së palodhur të njerëzve në qeverinë tonë dhe në Komitetin Olimpik të Kosovës. Ky rezultat është një kurorë ndërkombëtare

Great news for Kosovo and an extraordinary achievement!

We did it! Thank you very much. This is great news for Kosovo and an extraordinary achievement for all of us.

I express my heartfelt gratitude to all those who have supported our vision for the future of the country and the entire Mediterranean region.

We greatly appreciate the opportunity we have been given to host in our country, in Kosovo, the 26 member states from three continents.

This occasion is an illustrious symbol of our commitment to creating a better future, where the past is honored, the present is celebrated, and the future is shaped by a profound sense of unity.

As we embark on this journey towards Prishtina 2030, allow me to congratulate everyone in Kosovo, especially our athletes and sports community.

mbi zotimin rekord financiar dhe operacional në nivel kombëtar.

Le të kujtojmë se nuk bëhet fjalë vetëm për medalje dhe rekorde, por edhe për nxitjen e miqësive, shkëmbimeve kulturore dhe frymën e unitetit që kapërcen kufijtë.

Le të fillojnë përgatitjet, dhe unë ju garantoj se këto lojëra do të jenë një dëshmi e ndritur e madhështisë së Kosovës dhe rajonit të Mesdheut.

Ju faleminderit për mbështetjen dhe nderin e madh që i keni dhënë vendit tonë dhe kryeqytetit tonë, Prishtinës, për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030.

Albin Kurti,
Kryeministër i Kosovës
(Fjalim i mbajtur pas votimit në Asamblenë e Përgjithshme të ICMG-së)

This achievement is the result of the tireless work of people in our government and the Kosovo Olympic Committee. This result is an international crown over the record financial and operational commitment at the national level.

Let us remember that this is not only about medals and records, but also about fostering friendships, cultural exchanges and the spirit of unity that transcends borders.

Let the preparations begin, and I assure you that these games will be a shining proof of the magnificence of Kosovo and the Mediterranean region.

Thank you for the support and great honor you have given our country and our capital, Prishtina, for hosting the 2030 Mediterranean Games.

Albin Kurti
Prime Minister of Kosovo
(Speech held after the vote at the ICMG General Assembly)



“Fitore e fuqishme dhe historike”

Më meritori për marrjen e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, padyshim se është sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti.

Ai pati mundësinë të bëjë edhe një prezantim të nivelit të lartë para asamblistëve në Asamblenë e Përgjithshme të ICMG-së, duke shpalosur konceptin e organizimit të këtyre Lojërave në Kosovë.


Pas marrjes së rreth 90 për qind të votave, Aliti e quajti fitore të madhe votimin pro Kosovës.

“Forcën e një Komiteti Olimpik të një shteti e definojnë aftësitë për të organizuar një ngjarje shumë-sportëshe, andaj marrja e këtij organizimi nënkupton festë për mbarë kombën shqiptare. Është fitore e fuqishme dhe historike”, theksoi Aliti për RTK-në.

“Pak kush ka besuar që në më pak se nëntë vjet të anëtarësim-it të KOK-ut në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, do të marrim një organizim të tillë madhështor. Me këtë ia kemi dëshmuar botës se jemi një shtet i fuqishëm në sport dhe i gatshëm për të qenë organizator i një ngjarjeje multisportive”, shtoi Aliti.

Ai është edhe kryetar i komisionit vlerësues dhe koordinues për Lojërat Mesdhetare në rërë 2027.

Besim Aliti



PRISHTINA 2030

“Strong and historic victory”



The most deserving for the award to host the 2030 Prishtina Mediterranean Games is undoubtedly the Secretary General of the Kosovo Olympic Committee, Besim Aliti.

He had the opportunity to also deliver a top-level presentation before the assembly members at the General Assembly of the ICMG, unveiling the concept of organizing these Games in Kosovo.

After earning about 90 percent of the votes, Aliti called this a great victory for Kosovo.

“The strength of a country’s Olympic Committee is defined by the ability to organize a multisport event, so earning the bid to host these Games means celebration for the entire Albanian nation. It is a strong and historic victory,” Aliti emphasized for RTK.

“Few would have believed that in less than nine years of the Kosovo Olympic Committee’s membership in the International Olympic Committee, we would earn such a magnificent organization. With this we have proven to the world that we are a powerful sports country and ready to be host of a multisport event,” added Aliti.

He is also chair of the evaluation and coordination commission for the 2027 Beach Mediterranean Games.





Majlinda Kelmendi seeks to keep the gold medals in Kosovo

Olympic champion Majlinda Kelmendi congratulated the Kosovo Olympic Committee, the Government of Kosovo and the Ministry of Culture, Youth and Sports for earning the bid to host the 2030 Prishtina Mediterranean Games.

Our hero emphasized that the great successes of our athletes in the international arena undoubtedly also influence earning such organizations.

"I am extremely happy that the great successes of our athletes are being followed by serious organizations like the 2030 Prishtina Mediterranean Games. I appeal to leave the words behind, get to work, work to the maximum to show the world what value we have, not only as a sport but also as a nation, because we Albanians have hospitality as a virtue and let's try to succeed, to keep all the gold medals in Kosovo," stated Kelmendi.

She added that athletes since after the war have been the best ambassadors of our country, highlighting judo, which has three Olympic gold medals, two world golds, one precisely with Majlinda in Russia, and dozens of European ones.



XXI MEDITERRANEAN GAMES
HOST CITY
PRISHTINA 2030

Majlinda Kelmendi kërkon që medaljet e arta t'i mbajmë në Kosovë

Kampionia olimpike, Majlinda Kelmendi, ka përgëzuar KOK-un, Qeverinë e Kosovës dhe MKRS-në, për marrjen e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

Heroina jonë theksoi se ndikim në marrjen e organizimeve të tilla kanë padyshim edhe sukseset e mëdha të sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare.

"Jam jashtëzakonisht e lumtur që sukseset e mëdha të sportistëve tanë po përcillen me organizime serioze, siç janë Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030.

Unë po apeloj t'i lëmë fjalët, t'i vishemi punës, të punojmë në maksimum për t'i treguar botës se çfarë vlera kemi, jo vetëm si sport, por edhe si komb, sepse ne shqiptarët mikpritjen e kemi virtut dhe të mundohemi të kemi sukses, që të gjitha medaljet e arta t'i mbajmë në Kosovë", deklaroi Kelmendi.

Ajo shtoi se sportistët që prej pas luftës janë ambasadorët më të mirë të vendit tonë, duke veçuar sportin e xhudos, që ka tri medalje të arta olimpike, dy të arta botërore, njëren pikërisht me Majlindën në Rusi dhe dhjetëra të tilla evropiane.





Osmani: Mundësi ideale për bizneset dhe gastronominë



"The infrastructure we are building....in 2031, right away, there is interest from the Handball Federation to host the Handball World Championship. For this we will not need infrastructure investments, but we will continually have the opportunity to bring athletes and tourists to Kosovo.

It will be an ideal opportunity for gastronomy businesses to revive and benefit at that time," says

Daulina Osmani, Deputy Minister of Culture, Youth and Sports.

Zëvendësministrja për Kulturë, Rini e Sport, Daulina Osmani, ka deklaruar se organizimi i Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, është mundësi e artë edhe për zhvillimin e bizneseve të gastronomisë.

Ajo ka përmendur edhe shfrytëzimin e infrastrukturës pas vitit 2030.

"Infrastrukturën të cilën po e ndërtojmë, menjëherë në vitin 2031 kemi interesim nga Federata e Hendbollit për organizim të kampionatit botëror të hendbollit.

Për këtë ne nuk do të kemi nevojë për investime infrastrukturore, mirëpo vazhdimisht do ta kemi mundësinë të sjellim sportistë dhe turistë në Kosovë. Do të jetë mundësi ideale për bizneset e gastronomisë që të ringjallen e të përfitojnë në atë kohë", tha Daulina Osmani, zëvendësministrja për Kulturë, Rini e Sport.

Did you know...?

In 1979, Kosovo hosted the Junior Women's World Handball Championship. The Soviet Union was declared world champion after defeating East Germany in the final.

A e dini se...?

Në vitin 1979 në Kosovë ishte organizuar Kampionati Botëror i hendbollistëve për juniore. Kampionet e botës ishte shpallur Bashkimi Sovjetik, që në finale kishte mundur Gjermaninë Lindore.

10 medalistët e Kosovës në Lojërat Mesdhetare

Kosova u përfaqësua në dy edicionet e fundit të Lojërave Mesdhetare, derisa anëtare e ICMG-së ishte bërë më 31 tetor 2015. Në total u fituan 10 medalje.

- Distria Krasniqi (xhudo) – Tarragona 2018, medalja e artë
- Nora Gjakova (xhudo) – Tarragona 2018, e artë
- Akil Gjakova (xhudo) – Tarragona 2018, e artë
- Loriana Kuka (xhudo) – Tarragona 2018, e argjendtë
- Distria Krasniqi (xhudo) – Oran 2022, e artë
- Laura Fazliu (xhudo) – Oran 2022, e artë
- Loriana Kuka (xhudo) – Oran 2022, e artë
- Akil Gjakova (xhudo) – Oran 2022, e bronzte
- Flaka Loxha (xhudo) – Oran 2022, e bronzte
- Shpetim Bajoku (boks) – Oran 2022, e bronzte





Fidel Ylli: Është fitore e gjithë shqiptarëve



Fidel Ylli: It is a victory for all Albanians

The Albanian National Olympic Committee (KOKSH) also played an important role in the Prishtina 2030 bid, supporting the candidacy and contributing to the development of sailing in the Municipality of Durres.

The President of the KOKSH, Fidel Ylli, in addition to his speech at the Assembly, also spoke after the victory, highly appreciating the achievement, which he said belongs to all Albanians.

"It is a victory for all Albanians wherever they are, because we are one nation, we have the same customs, we speak the same language. In 2012 I was in Prishtina and I spoke about this unification, and unification does not happen through aggressive politics, but through sports, art and major projects," Ylli told RTK.

"This is a major project and although it is called Prishtina 2030, Albania is also here, where it has a very important part. We are one body and the victory was joint," he added.

Ylli also congratulated the presentation of the Secretary General of the Kosovo Olympic Committee, Besim Aliti, calling it dignified and top-level, where he explained every detail of the concept of organizing the 2030 Prishtina Mediterranean Games.



XXI MEDITERRANEAN GAMES
HOST CITY
PRISHTINA 2030

Rol të rëndësishëm në kandidaturën e Prishtina 2030, padyshim se kishte edhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të cilët mbështetën kandidaturën, duke kontribuar në zhvillimin e sportit të lundrimit në Bashkinë e Durrësit.

I pari i KOKSH-it, Fidel Ylli, krahas fjalimit në Asamble, u shpreh edhe pas fitores, duke vlerësuar lartë arritjen, për të cilën tha se është e gjithë shqiptarëve.

"Është fitore për gjithë shqiptarët kudo që janë, sepse jemi një komb, kemi të njëjtat zakone, flasim të njëjtën gjuhë. Në vitin 2012 kam qenë në Prishtinë dhe kam folur për këtë bashkim dhe bashkimi nuk bëhet përmes politikës agresive, por bëhet përmes sportit, artit dhe projekteve të mëdha", tha Ylli për RTK-në.

"Ky është projekt i madh dhe pavarësisht se quhet Prishtina 2030, këtu është edhe Shqipëria, ku ka pjesën e vetë shumë të rëndësishme. Ne jemi një trup i vetëm dhe fitorja ishte e përbashkët", shtoi ai.

Ylli përgëzoi edhe prezantimin e sekretarit të përgjithshëm të KOK-ut, Besim Aliti, duke e quajtur dinjitoz dhe të nivelit të lartë, ku shpjegoi çdo detaj të konceptit të organizimit të LM Prishtina 2030.

Medalistët nga Kosova në Lojërat Mesdhetare ndër vite

Mehmet Bogujevci (boks) – Split 1979, medalja e arte, ish-RFJ

Aziz Salihu (boks) – Latakia 1987, medalja e artë, ish-RFJ

Agim Latifi (boks) – Latakia 1987, medalja e artë, ish-RFJ



Fatmir Makolli (boks) – Latakia 1987, medalja e argjendtë, ish-RFJ

Nusret Rexhepi (boks) – Kasablanka 1983 – medalja e bronzitë ish-RFJ

Xhevdet Peci (boks) – Kasablanka 1983 – medalja e bronzitë ish-RFJ

Egzon Shala (mundje) - Mersin 2013 – medalja e bronzitë, përfaqësoi Shqipërinë

K O S O V O



**TOYOTA – PARTNER KRENAR I KOMITETIT
OLIMPIK TË KOSOVËS**



KOK-ut i besohet organizimi i Platformës Evropiane të Sportit 2024

Shtator/tetor - Pas Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, Komiteti Olimpik i Kosovës ka fituar të drejtën për organizimin e një tjetër ngjarje të rëndësishme në vendin tonë. Bëhet fjalë për organizimin e forumit ndërkombëtar për Platformën Sportive Evropiane (European Sport Platform) 2024.

KOK është partner në projektin ERASMUS + "Sporti si vlerë" për "Ngritjen e kapaciteteve në fushën e sportit", projekt që përfshinë nëntë partnerë nga tetë vende të Evropës. ENGSO është lider i projektit "Sporti si vlerë" dhe në kuadër të projektit, ngjarja madhore përmblylëse e projektit do të mbahet në Kosovë nën organizimin e KOK-ut.

Vendimi që KOK-u të jetë mikpritës i kësaj ngjarje të rëndësishme është marrë në mbledhjen e fundit të Komitetit Ekzekutiv të ENGSO-s, anëtar i së cilës KOK është prej vitit 2017.

ENGSO vepron si një organizatë ombrellë e 33 Komiteteve Olimpikë Kombëtare dhe Konfederatave Kombëtare të Sporteve përgjegjëse për sportin bazë, që nënkupton se në vendin tonë do të vijnë përfaqësues të 33 shteteve anëtare të kësaj organizate dhe të ftuar të tjerë nga organizatat sportive.

Dorëzimi i flamurit

Rreth një muaj më vonë (14 dhe 15 tetor) KOK-ut iu dorëzua edhe zyrtarisht organizimi i Platformës Evropiane të Sportit 2024 (ESP 2024), e paraparë të mbahet në tetor të vitit të ardhshëm në Prishtinë.

Dorëzimi për presidentin e KOK-ut, Ismet Krasniqi, është bërë në Lisbon të Portugalisë, nga Carlos Paula Cardoso, president i Federatës Konfederatës Portugeze të Sportit.

Në fjalimin e tij, presidenti Krasniqi, duke falënderuar drejtuesit e ENGSO-s për besimin, theksoi se ekipi i KOK-ut është i përkushtuar dhe i nderuar për të ofruar një përvojë të paharrueshme për të gjithë anëtarët e ENGSO-s, në mënyrë që ESP 2024 të mbahet mend për organizimin shembull dhe mikpritjen e ngrohtë.

Pikërisht në kryeqytetin portugez, për tri ditë është mbajtur Platforma Evropiane e Sportit 2023, në të cilët u zhvilluan punëtori të ndryshme, që kishin të bënin me: Barazinë në sport, qeverisjen e mirë dhe qëndrueshmërinë në sport.

Presidenti Krasniqi, që shoqërohej edhe nga zyrtarja për marrëdhënie ndërkombëtare, Rejhan Halili, njëherit anëtare e komisioneve: Barazia përmes sportit dhe komisionit këshillues të Bashkimit Evropian në ENGSO, dhe Marigona Mehmeti, e përfshirë në projektin "Sporti si vlerë", pati mundësinë të prezantojë projektet e fituara të KOK-ut në Erasmus Plus, sfidat dhe sukseset e KOK-ut, duke përmendur edhe marrjen e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

Kosovo will host European Sport Platform 2024

The organization of the European Sports Platform 2024 (ESP 2024), scheduled to be held in October next year in Pristina, has also been officially handed over to the Kosovo Olympic Committee (KOK).

The handover to the KOK president, Ismet Krasniqi, was made in Lisbon, Portugal, by Carlos Paula Cardoso, president of the Portuguese Sports Confederation.

In his speech, President Krasniqi, thanking ENGSO leaders for their trust, emphasized that the KOK team is dedicated and honored to provide an unforgettable experience for all ENGSO members, so that ESP 2024 will be remembered for its exemplary organization and warm hospitality.

Precisely in the Portuguese capital, the European Sports Platform 2023 was held for three days, in which various workshops were held, related to: equality in sports, good governance and sustainability in sports.

President Krasniqi, who was also accompanied by the official for international relations, Rejhan Halili, at the same time a member of the commissions: Equality through sport and the advisory commission of the European Union in ENGSO, and Marigona Mehmeti, involved in the project "Sport as a value", had the opportunity to present KOC's winning projects in Erasmus Plus, KOC's challenges and successes, mentioning also taking over the organization of the Prishtina 2030 Mediterranean Games.







Prishtina, “Qytet Evropian i Sportit 2024”


Kryeqyteti ynë, Prishtina, ka marrë epitetin “Qytet Evropian i Sportit për Vitin 2024”.
Vendimi u mor nga Parlamenti Evropian.

Është kjo një tjetër arritje e sportit tonë, veçanërisht Prishtinës, sukses ky në të cilin kontribuoi edhe Komiteti Olimpik i Kosovës.

KOK përgëzoi drejtuesit e komunës, me kryetarin Përparim Rama, dhe njëherit iu shprehu gatishmërinë për bashkëpunim në avancimin e mëtutjeshëm të sportit kryeqytetas dhe më gjerë.

URIME PRISHTINË!





Momente nga Asambleja e Përgjithshme e ICMG-së dhe fitorja e kandidaturës së Kosovës
Moments of the General Assembly of the ICMG and victory of the Kosovo's candidacy





Lojërat e para Evropiane, pa medalje për ekipin tonë

20 qershor – 1 korrik 2023 - Në Krakow të Polonisë u mbajt edicioni i tretë i Lojërave Evropiane. Për herë të parë ekipi ynë mbylli garat pa fituar ndonjë medalje.

Në total, Kosova kishte 38 sportistë të tetë sporteve të ndryshme, atletikë, boks, shenjëtari sportive, shigjetari, tekball, kajakim, taekwondo dhe çiklizmi.

Arritja më e madhe ishte vendi i pestë me boksierën, Donjeta Sadiku, e cila shënoi dy fitore dhe ishte një fitore larg medaljes dhe biletës për Lojërat Olimpike Paris 2024.

Suksesi shënoi edhe tekballisti Adrien Uka, i cili arriti deri në çerekfinale, duke përfunduar në tetë më të mirët.

Në atletikë, Muhamet Ramadani zuri vendin e tretë në Divizionin C, por që nuk llogaritet si medalje, pavarësisht se atleti ynë shënoi suksesin më të madh të ekipit të atletikës.

Në Krakow, këtë herë mungoi ekipi ynë ynë i xhudos, pasi organizatori në bashkëpunim me Unionin Evropian të Xhudos (EJU), kishin vendosur që në këtë edicion të Lojërave të mos ketë disiplinë individuale, por vetëm në ekipore.

Pikërisht në xhudo, Kosova numëron katër medalje, një të bronzte në Baku 2015 dhe një të artë, një të argjendtë dhe një të bronzte në Minsk 2019.



Donjeta Sadiku



Muhamet Ramadani



Adrien Uka





EOC nderon drejtuesit e KOK-ut

Gjatë qëndrimit në Lojërat Evropiane Krakow 2023, presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka ndarë dhe medaljet në dy ceremoni të karatesë.

E veçantë ishte medalja e ndarë për karateistin, Alvin Karaqi, i cili i sollti medaljen e artë Shqipërisë, të parën në histori të pjesëmarrjes së ekipit shqiptar në Lojërat Evropiane.

Karaqi më parë kishte garuar për Kosovën, madje duke e përfaqësuar në LE Baku 2015 dhe Minsk 2019.





Anëtari i Bordit Ekzekutiv të KOK-ut, Agron Mala, është nderuar nga Komiteti Olimpik i Evropës për të ndarë medaljet për ekipet fituese në disiplinën hark olimpik (recurve) të shigjetarisë në Lojërat Evropiane Krakow2023.

Medaljen e artë e fitoi Italia, të argjendtën, Spanja dhe të bronztën, Zvicra.

Mala është edhe kryetar i Federatës së Shigjetarisë së Kosovës.



Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti, është nderuar nga Komiteti Olimpik i Evropës (EOC) për të ndarë medaljet në ceremoninë karatesë, kategoria -75 kg.



Një vend i pestë në EYOF Maribor 2023

23-29 korrik 2023 - Ekipi ynë mori pjesë për herë të pestë në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj (EYOF), ku këtë herë u mbajt në Maribor të Sllovenisë.

Kosova u përfaqësua me 19 sportistë të sporteve të xhudos, atletikës, notit, tenisit dhe çiklizmit. Pjesëmarrëse ishin 48 shtete me mbi tre mijë sportistë të moshave 14-18 vjeç.

Suksesi më i madh ishin vendi i pestë me Blin Kukën dhe i shtati me Laurinë Gashin, të dy nga xhudo.

Pikërisht Gashi, së bashku me notarin, Arion Budima, bartën flamurin tonë në ceremoninë hapëse, ndërsa në mbyllje flamurbajtës ishin atletja, Emine Jonuzi dhe tenisti, Salidin Rama.

Kosovë deri më tani numëron vetëm një medalje në EYOF, atë me atletin Muhamet Ramadani, i cili fitoi të artën në Baku 2019.





KOSOVO



TEAM KOSOVO

KOSOVO
KOSOVO



26 sportistë dhe sporte të reja në LMR Heraklion 2023

9-16 shtator 2023 - 26 sportistë të pesë sporteve të ndryshme, përfaqësuan Kosovën në edicionin e tretë të Lojërave Mesdhetare në Rërë Heraklion 2023, të cilat u mbajtën në qytetin Heraklion të Greqisë.

Sportistët tanë ishin nga sportet e volejbollit në rërë, basketbollit 3x3, hendbollit në rërë, not në ujëra të hapura dhe karate në rërë. Basketbollit 3X3, hendbolli në rërë dhe karate në rërë, disiplina kata, përfaqësuan për herë të parë vendin tonë.

Ekipi ynë pati paraqitje solide, por pa mundur t'iu afrohet zonës së medaljeve.

Ekipi ynë parakaloi edhe në ceremoninë hapëse, ku të pranishëm ishin edhe drejtues të shtetit, të prirë nga kryeministri Albin Kurti, të cilët morën pjesë në Asambleshën e Përgjithshme të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare, në të cilat u vendos që Kosova të organizojë Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030.



Ekipet e basketbollit



Pamje nga një ndeshje e hendbollit në rërë



Ekipi i meshkujve në volejboll në rërë



Ventor Gjuka (karate kata)



Sidrit Desku dhe Arion Budima (not 5km)

Katër medalje të fituara në Lojërat Frankofone Kinshasa 2023

28 korrik – 6 gusht 2023 - Katër medalje të fituara, një e artë, dy të argjendta dhe një e bronzë, është bilanci i ekipit të Kosovës, pjesëmarrës në Lojërat Frankofone Kinshasa 2023, të mbajtura në Kinshasa të Republikës Demokratike të Kongosë.

Medaljen e artë e fitoi xhudisti Shpat Zekaj, në kategorinë deri në 100 kilogram.

Medaljen e argjendtë e fituan dy atletët, Muhamet Ramadani në hedhjen e gjylës dhe Gresa Bakraqi në vrapim 3000 metra me pengesa.

Xhudisti tjetër, Dardan Cena, u stolis me medaljen e bronzë, kategoria -73 kg.


Ekipi ynë u përfaqësua me gjashtë sportistë. Dy të tjerët ishin pingpongistët Alma Mehmeti dhe Fatih Karabaxhaku, të cilët suksesin më të madh e patën arritjen deri në çerekfinale, disiplina individuale.

Për Kosovën ishte pjesëmarrja e dytë në Lojërat Frankofone, pas asaj të vitit 2017.



Gresa Bakraqi (e para majtas)





Presidenti i EOC-ut, Spyros

Presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës (EOC), Spyros Capralos, ka vizituar për herë të parë Kosovën, me ç'rast ka zhvilluar takime të ndryshme.

Capralos, që shoqërohej nga sekretari i përgjithshëm, Raffaello Pagnoni, fillimisht vizituan Komitetin Olimpik të Kosovës, ku u pritën nga presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti.

Ai pa nga afër zyret e reja të KOK-un, takoi stafin dhe më pas zhvilloi takim me drejtuesit e KOK-ut, e ku të pranishëm ishin edhe udhëheqësit e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të cilët e kishin shoqëruar nga vizita që kishte në Tiranë, Shqipëri.

Capralos më pas është pritur edhe nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe ministri për Kulturë, Rini e Sport, Hajrullah Çeku, me të cilin diskutuan për sukseset e sportit të Kosovës, veçanërisht tri medaljet e arta olimpike në xhudo, mbështetjen që po jep Qeveria e Kosovës për sportin dhe marrjen e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

Në fund të vizitës së tij dy ditëshe (17 dhe 18 dhjetor 2023), presidenti Capralos bashkë me presidentin e KOK-ut, Ismet Krasniqi, dolën para mediave të shumta.

Presidenti Capralos vlerësoi lartë progresin e KOK-ut në dy-tri vitet e fundit, sidomos marrjen e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, derisa shprehu mbështetjen në projekte të ndryshme të KOK-ut. Ai veçoi sukseset e sportistëve tanë, me shpresën se shumë shpejtë Kosova do të fitojë medalje olimpike edhe në sportet tjera.

Nga ana e tij, presidenti Ismet Krasniqi, shprehu kënaqësinë e mikpritjes së njeriut të parë të sportit në Evropë, duke thënë se vizita e tij i jep mbështetje edhe më të fuqishme projekteve të KOK-ut.



Capralos, vizitoi Kosovën



EOC President Spyros Capralos visits Kosovo

The President of the European Olympic Committee (EOC), Spyros Capralos, visited Kosovo for the first time, holding various meetings.

Capralos, who was accompanied by Secretary General Raffaele Pagnozzi, first visited NOC-Kosovo, where they were welcomed by President Ismet Krasniqi and Secretary General Besim Aliti.

He showed keen interest in NOC-Kosovo's new offices, met with staff, and later held a meeting with NOC-Kosovo heads, which also attended by the heads of the Albanian National Olympic Committee, who had accompanied him on his visit in Tirana, Albania.

Capralos was then received by the Prime Minister of Kosovo, Albin Kurti, and the Minister of Culture, Youth and Sport, Hajrullah Çeku, with whom they discussed the successes of Kosovo sports, especially the three Olympic gold medals in judo, the support provided by the Government of Kosovo for sports, and the hosting of the Prishtina 2030 Mediterranean Games.

At the end of his two-day visit (December 17 and 18, 2023), President Capralos together with NOC-Kosovo President Ismet Krasniqi, met with numerous reporters.

President Capralos highly praised the progress made by

NOC-Kosovo over the last two or three years, especially the hosting of the Prishtina 2030 Mediterranean Games, while expressing his support for various NOC-Kosovo projects. He singled out the successes of our athletes, with the hope that very soon Kosovo will win Olympic medals in other sports as well.

For his part, President Ismet Krasniqi expressed the pleasure of hosting the head of sports in Europe, stating that his visit provides even more powerful support to NOC-Kosovo projects.

KOSOVO



EUROPEAN
OLYMPIC
COMMITTEES





Foto nga vizita e presidentit Capralos në Kosovë





OLIMPI | 2





**Have It
Your Way®**



TM & Copyright 2023 Burger King®. All Rights Reserved.

Lokacionet

- | | | |
|-----------------------------|---------------------------|--------------------------------------|
| 01 BK Qender | 06 BK Arberia | 11 BK Abi Qarshia |
| 02 BK Prishtina Mall | 07 BK Bresje | 12 BK Village Ferizaj |
| 03 BK Albi Mall | 08 BK Çagllavica | 13 BK HIB Ferizaj |
| 04 BK Royal Mall | 09 BK Peja | 14 BK Airport "Adem Jashari". |
| 05 BK Pejton | 10 BK Galeria Mall | |

DISPLAY MARKETING



WEB BANNER



LIVESTREAM VIDEO
BANNER



IN-VIDEO BANNER

LIVESTREAMING



PËRCJELLJA E
AKTIVITETEVE LIVE



LIVESTREAM NË
SOCIAL MEDIA



LIVESTREAM NË RRJETIN E
PARTNERËVE MEDIAL

PRODUKSION



DOKUMENTAR



EMISIONE



PRODUKTE MEDIALE
TË SPONZORIZUARA



STORIE SUKSESI

PR



ARTIKUJ TË
SPONZORIZUAR



ANALIZA &
HULUMTIME



VIDEO
PROMOVUESE



HARTIMI I
STRATEGJISË SË PR



KOK dhe BKT Kosova nënshkruajnë kontratë sponsorizimi në vlerë 3 mln. Euro për 10 vite

5 dhjetor 2023 - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) dhe BKT Kosova kanë thelluar bashkëpunimin, duke nënshkruar kontratë të re sponsorizimi.

Kontrata e re, vlen për 10 vitet e ardhshme, ndërsa vlera e saj totale është 3 milionë euro, që e bënë BKT Kosovën, sponsorin më të madh ndonjëherë në Komitetin Olimpik të Kosovës.

Kontrata u nënshkrua nga presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi dhe Suat Bakkal, kryeshef ekzekutiv dhe Anëtar Bordi në BKT Kosova. Krahas drejtuesve tjerë të KOK-ut dhe BKT-së, të pranishëm ishin edhe kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama dhe drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, Ibër Alaj.

Presidenti Krasniqi deklaroi se bashkë me BKT Kosova do të rrugëtojnë drejt Lojërave Olimpike Paris 2024, Los Anxhelos 2028, Brisbane 2032, si dhe ngjarjes historike – Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

“Kemi kënaqësinë që sot po e thellojmë bashkëpunimin me bankën më të mirë në Kosovë. Ne kemi pasur një marrëveshje paraprake dy vjeçare me BKT Kosova, në vlerë 100 mijë euro në vit, kurse me marrëveshjen e re, vlera totale është 3 milionë euro, ose 300 mijë euro në vit. Kjo nuk është e tëra, pasi me BKT Kosova na lidh edhe marrëveshja tjetër përmes kampanjës “Be Hero”, tha mes tjerash presidenti Krasniqi, duke shtuar se përfuturit më të mëdhenj të kësaj marrëveshje janë sportistët dhe vetë sporti i Kosovës.

Suat Bakkal, drejtor ekzekutiv i BKT Kosova, konfirmoi mbështetjen e palëkundur të BKT Kosovë për sportin në Kosovë, duke njohur arritjet mbresëlënëse të vendit në këtë fushë.

“Ky partneritet i vazhduar më tej kontribuon në zhvillimin dhe promovimin e sportit dhe sportistëve në nivelin më të lartë, për të çuar përpara sportin kosovar dhe sportistët që po shkëlqejnë çdo ditë në fushat e tyre, dhe më e rëndësishmja po bëhen ambasadorë të denjë të vendit. Kosova është shtet i ri dhe tashmë ka fituar tri medalje të arta olimpike. Suksesi i sportistëve Kosovarë ka bërë jehonë në mbarë botën, dhe sporti tani më, po bëhet eksporti më i madh i Kosovës, andaj arritja e kësaj marrëveshje afatgjatë sot na bën ne, BKT Kosovën krenare që jemi pjesë e regjimeve të reja të suksesit në vitet në vijim, theksoi Bakkal.

Ai përmendi edhe kampanjën “Bëhu Hero”, por edhe projekte tjera, përmes të cilave BKT Kosova ka mbështetur sportin në Kosovë.

A e dini se...?

Kampanja e lansuar javë më parë nga KOK dhe BKT Kosova, ka të bëjë me kredit kartelat visa të BKT Kosova, ku çdo kush që paguan përmes tyre, 1 për qind shkon në llogarinë e KOK-ut, para këto që dedikohen për sportistët në rrugëtimin e tyre drejt Lojërave Olimpike Paris 2024.



Kosovo Olympic Committee and BKT Kosovo Sign a 10-Year Sponsorship Contract Worth 3 Million Euros

The Kosovo Olympic Committee (KOC) and BKT Kosovo have deepened their collaboration by signing a new sponsorship contract. The new 10-year sponsorship contract worth €3 million total, making BKT Kosovo the largest sponsor in the history of Kosovo Olympic Committee.

The contract was signed by KOC President Ismet Krasniqi and Suat Bakkal, CEO and Board Member at BKT Kosovo. Also present were Pristina Mayor Përparim Rama and the Director of the Sport Department in the Ministry of Culture, Youth and Sport, Ibër Alaj.

President Krasniqi stated that together with BKT Kosovo, they will journey towards the 2024 Paris Olympics, 2028 Los Angeles Olympics, 2032 Brisbane Olympics, and the historic 2030 Pristina Mediterranean Games.

"We are pleased to deepen our cooperation with the best bank in

Kosovo. We previously had a two-year agreement with BKT Kosovo worth €100,000 annually, while under the new agreement the total value is €3 million, or €300,000 per year. Additionally, we are linked with BKT Kosovo through another agreement via the Be Hero campaign," said President Krasniqi, adding that athletes and Kosovo's sport itself are the biggest beneficiaries.

The recently launched "Be Hero" campaign involves BKT Kosovo's Visa credit cards, where 1 percent of payments go to the KOC account.

BKT Kosovo CEO Suat Bakkal confirmed their steadfast support for sports in Kosovo, acknowledging the country's impressive achievements in this area. He highlighted the "Be Hero" campaign and other projects through which BKT Kosovo has backed Kosovar sport.



Pesë sportistë përkrahen me bursa në rrugën për LOD Milano Kortina 2026

Shtator 2023 – KOK-u do të ndajë bursa për sportistë, të cilët do të synojnë normën olimpike për Lojërat Olimpike Dimërore Milano Kortina 2026.

Gjithsej pesë sportistë të sportit të skijimit alpin do të mbështeten me nga 600 dollarë në muaj, falë mbështetjes së marrë nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Janë këta: Arbi Pupovci, Drin Kokaj, Klos Vokshi, Kiana Kryeziu dhe Lirika Deva, të cilët synojnë të kualifikohen për LOD 2026.

Prej tyre, vetëm Kryeziu është përfaqësuar në Lojërat Olimpike Dimërore Pekini 2022.



Five Athletes Receive Scholarships for Milano Cortina 2026 Winter Olympics Journey

September 2023 – The Kosovo Olympic Committee (KOC) has announced scholarships for athletes striving to meet the Olympic standard for the Milano Cortina 2026 Winter Olympic Games. Five alpine skiers have been selected for this program, each receiving a monthly stipend of \$600. This initiative is made possible through the support of the Olympic Solidarity of the International Olympic Committee.

The beneficiaries of this scholarship are Arbi Pupovci, Drin Kokaj, Klos Vokshi, Kiana Kryeziu, and Lirika Deva. All of them

are working hard to qualify for the LOD 2026. Among these athletes, Kryeziu holds the distinction of having represented at the Beijing 2022 Winter Olympic Games.

EMRI/MBIEMRI	SPORTI	VLERA
Arbi Pupovci	Skijim alpin	600 \$
Drin Kokaj	Skijim alpin	600 \$
Klos Vokshi	Skijim alpin	600 \$
Kiana Kryeziu	Skijim alpin	600 \$
Lirika Deva	Skijim alpin	600 \$

Logos: KOSOVO, IOC, MILANO CORTINA 2026

Logos: BKT, Olive, KOC, qjirafa.com, HOTEL SPUS, etc.

PUSHIME VERORE
PUSHIME DIMRORE
PUSHIME TROPIKALE

BILETA NË TË GJITHË BOTEN
ORGANIZIME TË KORPORATAVE
PAKETA FAMILJARE UDHËTIMI



PRIMETRAVEL
KS-CH Smile





Vizita e kryeministrit Kurti në KOK

Gusht 2023 - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar për herë të parë Komitetin Olimpik të Kosovës, me ç'rast u prit nga drejtuesit e KOK-ut, me në krye presidentin Ismet Krasniqi.

Të pranishëm në takim ishin edhe zëvendësministrja e MKRS-së, Daulina Osmani, sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti dhe nënpresidentët, Gazmend Maxhuni e Milaim Kelmendi.

Presidenti Krasniqi falënderoi kryeministrin Kurti për angazhimin e tij në mbështetje të sportit dhe sportistëve, si dhe përkushtimin për përmirësimin e kushteve infrastrukturore.

Kryeministri Kurti, përgëzoi drejtuesit e KOK-ut për zyrat e reja, derisa vlerësoi punën dhe të arriturat e KOK-ut, me theks të veçantë rezultatet e sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare. Palët u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit në arritjen e qëllimit për marrjen e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, për çka presidenti Krasniqi falënderoi kryeministrin për mbështetjen e fuqishme.

U dakordua edhe për bashkëpunim në rrugën drejt prezantimit sa më të mirë edhe në Lojërat Olimpike Paris 2024.





FORUMI PËR SPORTIN FORUM OF SPORT



Lojërat Mesdhetare u diskutuan në “Forumin për Sportin”

29 shtator 2023 – KOK-u në bashkëpunim me Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, ka organizuar edicionin e pestë të konferencës “Forumi për Sportin”, që u mbajt në kuadër të Javës Evropiane të Sportit 2023.

Presidenti i KOK-ut, duke bërë thirrje që të jemi sa më aktivë (Be Active), që është edhe motoja e Javës foli për mikpritjen e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, si dhe organizimit të forumit ndërkombëtar Platforma Evropiane e Sportit 2024, për të cilat tha se të gjithë bashkërisht synojmë të jemi shembull i organizimit dhe frymëzimit për të tjerët.

Koordinatori nacional i Javës Evropiane të Sportit në Kosovë, Ibër Alaj, foli për aktivitetet e organizuara dhe rëndësinë që ka marrja me aktivitete fizike.

Konferenca u zhvillua në formë të panelit, ku në panel krahas Alajt, ishin edhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti, drejtori i sportit në Komunën e Prishtinës, Granit Rugova, trajnerja e gjimnastikës, Abeliانا Bregu dhe gjyqtarja e tenisit, Blearta Ukëhaxhaj, njëherit ambasadore e Kosovës për promovimin e vlerave olimpike në garat e EYOF-it.

Panelistët folën për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030, si dhe të qenit aktivë me aktivitete fizike, derisa të pranishmit, që kryesisht ishin drejtues të federatave sportive, përfaqësues të MKRS, dekani i FEFS, Musa Selimi, patën mundësinë të diskutojnë për LM Prishtina 2030, duke kërkuar njëkohësisht sqarime të nevojshme në lidhje me mënyrën e organizimit dhe investimeve që do të bëhen nga Qeveria e Kosovës.

Aktiviteti u përcjell edhe me video të Javës Evropiane të Sportit.



NOC-Kosovo hosts “Sport Forum” Conference, within the framework of the European Week of Sport

NOC Kosovo, in cooperation with the Ministry of Culture, Youth and Sports, hosted the fifth edition of the “Sport Forum” Conference, which was held within the framework of the European Week of Sport 2023.

While calling for everyone to be as active as possible (BeActive), which is also the motto of the Week, the NOC-Kosovo President spoke about the hosting of the Mediterranean Games Prishtina 2030, as well as the organization of the European Sports Platform 2024 International Forum, about which he added that the common aim is to be an example of good organization and an inspiration to others.

European Week of Sport National Coordinator for Kosovo, Ibër Alaj, spoke about the organized activities and the importance of physical activities.

The conference took place in the form of a panel, which in addition to Alaj was composed of NOC-Kosovo Secretary General Besim Aliti, Municipality of Prishtina Sports Director Granit Rugova, gymnastics coach Abeliana Bregu, and tennis referee Blearta Ukëhaxhaj, at the same time Kosovo ambassador for the promotion of Olympic values in EYOF competitions.

Panelists talked about the Mediterranean Games Prishtina 2030, and about being active with physical activities, while the attendees, who were primarily heads of sports federations, MCYS representatives, FPES dean Musa Selimi, had the opportunity to discuss about Prishtina 2030 MG, and also requested the necessary clarifications regarding the manner of organization and investments that will be made by the Government of Kosovo.

The activity was also followed by a video of the European Week of Sport.

The European Week of Sport opened on September 23, and was closed on September 30, 2023.



KOK NGA VITI 2024 PROGRAMIN E EDUKIM



**Diellza
Kelmendi**

Akademia Olimpikë e Kosovës do të ofron studime të rregullta në programin e studimit të nivelit të pestë sipas kornizës kombëtare të kualifikimeve, themeluar në bazë të ligjit Nr. 03/L-060, datë 07.11.2008 “Për Kualifikimet Kombëtare”.

Akademia Olimpikë e Kosovës si hap të parë ka hartuar standardin e profesionit për nivelin e pestë, i cili është një dokument që përshkruan kërkesat e punës dhe kompetencave profesionale, do të thotë një grup të aftësive, njohurive dhe qëndrimeve të nevojshme për kryerjen e suksesshme të punës si trajner i sportit.

Programi “Trajner Sportiv”, është profesion në kuadër të profesioneve të klasifikuara në librin e klasifikimeve të profesioneve në Kosovë. Trajneri Sportiv kryen funksione të ndryshme që kanë të bëjnë me trajnim dhe edukim në fushën e sportit. Programi “Trajner Sportiv” ofron edukimin dhe përgatitjen profesionale të trajnerëve në fushën e sporteve, në drejtimin e menaxhimit individual dhe grupor në një disiplinë sportive.

Pas përfundimit të programit të studimit Akademia Olimpikë e Kosovës lëshon “Certifikatë kombëtare profesionale”.

Rëndësia e “Trajnerit Sportiv”

Në klubet sportive të Kosovës ka nevojë të theksuar për staf profesional, për realizimin e detyrave profesionale të trajnimit bazë të personave që janë pjesë e sportit. Vitet e fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të njerëzve që janë të përfshirë në mënyrë aktive ose duan të jenë pjesë e sportit.

Kjo rritje kërkon trajnimin e një numri të konsiderueshëm personash, që do të kishin një nivel fillestar të kompetencave për të kryer punë profesionale në sportet tona.

Qëllimi kryesor i këtij programi është edukimi i trajnerëve përmes përvetësimit të njohurive dhe aftësive moderne teorike dhe praktikisht të zbatueshme për punë të suksesshme profesionale në organizatat dhe klubet sportive.

Rëndësia e një trajneri të kualifikuar profesional, është thelbësore për punën në sport dhe zë një vend të lartë në sistemin sportiv. Pa kualifikim adekuat profesional nuk ka kompetencë dhe pa kompetencë nuk ka punë cilësore profesionale dhe pedagogjike të trajnerëve sportiv.

Roli i trajnerit është shumë i rëndësishëm, sidomos kur bëhet fjalë për arritjen e rezultateve të larta sportive, të cilat për nga rëndësia shkojnë përtej vetë suksesit sportiv dhe kuadrit sportiv, tashmë kanë një rëndësi domethënëse, ekonomike, sociale, kulturore, madje edhe historike.

Përmes strukturës së duhur të kurikulës së këtij programi, pjesëmarrësit do të përvetësojnë njohuritë mbi kineziologjinë, anatominë, fiziologjinë, psikologjinë, pedagogjinë, të ushqyerit në sport, biomekanikë sportive, metodave stërvitore, teoria e trajningut sportiv, edukimin olimpiq, përgatitjet e procesit stërvitor në sport, teknikat dhe taktikat në disiplina përkatëse sportive, menaxhimin në sport, edukimin fizik special.

Përmbajtja kurrikulare e këtij programi në detaje është përzgjedhur me kujdes për të përmbushur nevojat e trajnerëve, që do të punojnë me atletë përgjithësisht të rinj, në zhvillim, si dhe me atletë të avancuar të sportit elitari.

Duhet theksuar se kandidatët pas përfundimit me sukses të moduleve, do të jenë në gjendje që në mënyrë vetanake të udhëheqin dhe të zotojnë kompetenca profesionale, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e fituara teorike dhe praktike për të punuar në programimin dhe zbatimin e proceseve stërvitore dhe garave sportive, si dhe aplikimin e modeleve moderne të punës pedagogjike individuale dhe ekipore me sportistë të të gjitha moshave.

Programi për “Trajner Sportiv” është i konceptuar në standardet evropiane dhe i orientuar në kuptimin teorik dhe praktik. Pas përfundimit të programit, trajnerët do të pajisen me njohuri dhe kompetenca që janë ekuivalente me nivelin 5 të kornizës kombëtare të kualifikimeve.



OFRON STUDIME NË IT “TRAJNER SPORTIV”



Kohëzgjatja e programit të edukimit “Trajner Sportiv”

Kohëzgjatja e programit të studimit të nivelit të pestë “Trajner Sportiv”, është me kohë të plotë dhe zgjat vetëm një vit, dhe për të fituar një certifikatë nga Akademia Olimpikë e Kosovës kandidati/tja duhet të ketë grumbulluar 60 ECVET kredi.

Programi i studimit është i organizuar në module dhe të vlerësuara në kredi (ECVET). Sasia mesatare e punës së kryer nga kandidati gjatë një viti studimesh me kohë të plotë për nivelin e pestë “Trajner Sportiv”, është 1200 orë mësimore (60 kredi ECVET), që përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur.

Në Akademinë Olimpikë veprimtaritë formuese do të realizohen nëpërmjet mësimit në auditor (ligjërata, ushtrime praktike), studimit individual (studim, detyra apo projekte, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës përfundimtare) dhe praktika profesionale.

Shpërndarja e kredive sipas veprimtarive formuese brenda një lënde përcaktohet nga profesori i lëndës në funksion të natyrës së disiplinës dhe shprehet në planet mësimore, dhe në formatin

Pjesa e ligjeratave teorike të programit do të zgjasë 360 orë ;

Pjesa e ushtrimeve praktike të programit do të zgjasë 265 orë;

Pjesa praktike në klubin sportiv – “internship” do të zgjasë 100 orë.

Struktura e personelit akademik

Personeli akademik personifikon cilësinë e studimit në programin “Trajner Sportiv”. Për këtë arsye, menaxhmenti i Akademisë Olimpikë ka bërë përzgjedhjen më të mirë të mundshme të personelit akademik.

Stafi akademik është 100% me kualifikime adekuate dhe me përvojën e nevojshme në arsim, kjo dëshkohet përmes CV-ve të tyre, ku krahas kompetencave profesionale kanë edhe një numër të publikimeve shkencore në revista, kryesisht ndërkombëtare.

Akademia Olimpikë e Kosovës në strukturën e saj ka staf akademik të kualifikuar, me përvojë të dëshmuar në sferën e sportit si dhe në mësimdhënie.

Për të gjitha modulet mësimore të përfshira në planin dhe programin mësimor, kuadri është plotësisht profesional, me thirrje adekuate në lëndën e caktuar me eksperiencë universitare. Në këtë mënyrë, ne lidhim teorinë dhe praktikën për t'u dhënë kandidatëve aftësitë e nevojshme.

Ndershmëria akademike është qeliza kryesore në ruajtjen e integritetit të Akademisë Olimpikë të Kosovës dhe bashkësisë së saj. Personeli akademik do të bëjë transparent mënyrën e vlerësimit dhe testimet e njohurive të kandidatëve, në metodologjinë e përdorur dhe me rezultatet e tyre.

Akademia Olimpikë e Kosovës si prioritet kryesor të saj ka krijimin e një mjedisi pune, i cili ju mundëson të gjithë stafit akademik të zhvillojnë dhe aplikojnë kapacitetet dhe aftësitë e tyre për të mbështetur misionin dhe vizionin e Akademisë Olimpikë.



Infrastruktura dhe burimet njerëzore

Komiteti Olimpik i Kosovës ka krijuar marrëdhënie kontraktuale me UP-në për shfrytëzimit e ambienteve në objektin e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, e cila posedon kushte shumë të mira për realizimin e proceseve mësimore.

Në kuadër të aktiviteteve vendore ne kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunime me Kolegjin privat AAB, Akademinë Olimpikë të Shqipërisë, ndërsa në arenën ndërkombëtare Akademia Olimpikë është anëtare e Akademisë Olimpikë Ndërkombëtare dhe Akademia Olimpikë e Evropës.

Kapacitetet ekzistuese infrastrukturore mundësojnë zhvillimin normal të mësimit për rreth 50 kandidatë për çdo vit akademik.

Gjatë studimeve, kandidatëve ju mundësohet trajtim i barabartë edhe i veçantë në bazë të specifikave të tyre të parapara në rregulloren e AOK-ut.

Metodologji bashkëkohore e punës, mjedis adekuat bazuar në standardet evropiane të cilësisë, me teknologji të avansuar, salla për ushtrime praktike me pajisje të nevojshme dhe material shpenzues për realizimin në përpikmëri të tyre. Hapësirat e punës janë të pastërta, të sigurta dhe të dezinfektuara në bazë të rregullave të IKPSHK-së.

Në kuadër të trajtimit fleksibil, në raste të veçanta kur kandidatët kanë probleme shëndetësore, ka paraparë trajtim të veçantë, varësisht nga situata, e cila duhet t'i paraprijë një kërkesë me arsyetim të argumentuar.



Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale të “Trajnerit Sportiv”

Personi në këtë profesion mund të jetë i punësuar në pozita të ndryshme si një trajner, instruktor, udhëheqës, konsulent/ këshilltar, dhe si ekspert sportiv, etj. Trajneri sportiv mund ta fitojë këtë kualifikim vetëm nëse ndjekë trajnimin sipas moduleve dhe kalon me sukses provimet e të gjitha moduleve (lëndëve teorike dhe ushtrimet praktike).

Bazuar në kornizën kombëtare të kualifikimeve, certifikatat apo diplomat e fituara për këtë nivel të arsimimit janë të nivelit 5 të kualifikimeve, të cilat shërbejnë për të dalë në treg të punës, ose për t'u rikualifikuar për punë të caktuar.

“Trajneri Sportiv” mund të punojë në vendet e punës si në vijim:

1. Shoqata sportive;
2. Klubet sportive;
3. Federata sportive;
4. Klube dhe federata ndërkombëtare.

Kandidati i diplomuar në programin “Trajner Sportiv” është ekspert në trajnime sportive të përgjithshme krahas një sporti specifik. Kjo njohuri i mundëson të diplomuarit të planifikojë dhe zbatojë programe stërvitore në sportin e tyre specifik në të gjitha kategoritë e moshave dhe të gjitha nivelet e performancës sportive.

Kompetencat e fituara pas përfundimit të programit “Trajner Sportiv”

Ofron format metodologjike dhe organizative të punës në sportin përkatës;

Bën analizën bazë të procesit stërvitor në sportin përkatës;
Bën analizën bazë të teknikës në sportin përkatës;
Bën analizën bazë të taktikës në sportin përkatës;
Përshkruan funksionet elementare dhe funksionimin e sistemeve lokomotore, kardiovaskulare dhe të frymëmarrjes të trupit të njeriut;
Përshkruan proceset fiziologjike në trupin e njeriut me theks të veçantë në ndikimet e mundshme në to gjatë aktivitetit kineziologjike;
Përshkruan mekanizmat e lëndimeve në sport dhe miraton procedura për parandalimin e tyre;
Përshkruan njohuri teorike dhe praktike për testimin dhe

monitorimin e performancës sportive;

Zotëron njohuri për rolin e sportit në zhvillimin e shoqërisë në shtetin e Kosovës;

Identifikon dhe përshkruan proceset psikologjike që ndodhin në bazë të formave të ndryshme të sjelljes dhe identifikon nevojat dhe rregullat themelore për komunikim të suksesshëm në trajnim;

Përdorë konceptet bazë të statistikës dhe informatikës dhe të kuptoj nevojat e përpunimit të dhënave të mbledhura;

Zotëron njohuri për olimpizmin dhe edukimin olimpik;

Zotëron njohuri mbi rëndësinë dhe aspektet bazë biomekanike të sportit;

Zotëron njohuri për menaxhimin dhe marketingun sportiv;





Festivali i 3-të Ndërkombëtar i FICTS Filmit Sportiv Prishtina 2023

20-21 tetor 2023 – 14 filma të zhanreve dokumentarë të shkurtër, dokumentarë të gjatë, storje, etj, tetë prej të cilëve ishin vendor, u shfaqën në Festivalin Ndërkombëtar të FICTS Filmit Sportiv Prishtina 2023, i cili u mbajt në kinemanë ABC në Prishtinë.

Dy filma u dhanë premierë. Njëri "Mija", i autorese Vjollca Maqedonci – Osmani, që u shfaq të premtën dhe që i dedikohet legjendës së basketbollit kosovar, Resmije Juniku dhe "Heroi i heshtur", i autorit Kastriot Saqipi, që i kushtohet menaxherit të parë të FIFA-së, të ndjerit, Hasan Kadriu.

Të dy dokumentarët zgjuan kërshëri të madhe të shikuesve, sikurse "Kryemjeshtri", "Rrugëtim prej kampioni", "Një ikonë si Fadil Vokrri", "Pa vend", "Vrapuesi i cili humbi një dorë synon Lojërat Paralimpike Paris 2024", "Tregim inspirues i futbollistit nga Gjilani, Enis Xhemali", etj.

Disa prej këtyre dokumentarëve, konkurrojnë për çmime edhe në Festivalin Botëror të Filmit Sportiv, që organizohet muajin e ardhshëm në Milano të Italisë nga Federata Ndërkombëtare e Kinematografisë Sportive (FICTS).

Në ceremoninë hapëse, anëtarja e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut, Besire Domaniku, foli për rëndësinë që ka organizimi i këtij Festivali dhe promovimi i historisë tonë, sfidave dhe sukseseve përmes realizimit të dokumentarëve, të cilët krahas vendit tonë, kanë mundësi të shfaqen edhe në kinematë botërore.

Drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, Ibër Alaj, theksoi se MKRS ka mbështetur disa prej filmave, dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë edhe në të ardhmen. Presidenti i FICTS-it, Franco Ascani, përmes një video-mesazhi, deklaroi se Festivali jep mundësinë e promovimit të vlerave kulturore të lëvizjes olimpike dhe kulturën përmes sportit.

Krahas drejtuesve të federatave sportive, kontribuuesve të sportit, trajnerëve, sportistëve, regjisorëve, etj, festivali u vizitua

edhe nga ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, këshilltarja e kryeministrit Albin Kurti, Ardita Sinani, trajneri i Kombëtares Shqiptare të futbollit U-21, Alban Bushi, etj.

KOK prej vitit 2020 ka nisur organizimin e Festivalit të Filmit Sportiv, një vit pas anëtarësimit në FICTS.



KOK fiton edhe një çmim në Festivalin Botëror të Filmit Sportiv Milano 2023

Nëntor 2023 - KOK-u ka fituar një tjetër çmim ndërkombëtar, këtë herë në Festivalin e 40-të Botëror të Filmit Sportiv, të organizuar në Milano të Italisë nga Federata Ndërkombëtare e Kinematografisë Televizive Sportive (FICTS).


Nga pesë filmat sportivë/dokumentarë të dërguar për çmime, Kosova është shpërblyer për storjen "Kryemjeshtri", të realizuar nga KOK-u dhe që i dedikohet trajnerit me tri medalje të arta olimpike, Driton Kuka.

Çmimi i fituar është "Mention D'Honneur", në kategorinë "Sporti dhe shoqëria – vlerat sportive, edukative dhe kulturore".

Çmimi iu dorëzua zyrtarit për media në KOK, Kushtrim Krasniqi, nga presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Kinematografisë Sportive, Franco Ascani. Është ky çmimi i tretë në katër vjet që fiton KOK-u pas: "Përtej Ëndrrës" nga "OM Production" dhe "Kosova e Artë", i realizuar po ashtu nga KOK-u.

Për pesë ditë në Milano (7-11 nëntor 2023), u shfaqën mbi 140 filma të ndryshëm sportivë nga mbi 100 vende të botës, anëtare të FICTS, e në mesin e tyre, krahas "Kryemjeshtrit", ishin edhe storjet dhe dokumentarët vendorë: "Një ikonë si Fadil Vokrri", "Pa vend", "Vrapuesi, i cili humbi një dorë synon Lojërat Paralimpike Paris 2024" dhe "Tregim inspirues i futbollistit nga Gjilani, Enis Xhemaili".

Po ashtu, në konferenca të veçanta u prezantua edhe Festivali Ndërkombëtar i Filmit Sportiv Prishtina 2023, i mbajtur në muajin tetor në kinemanë ABC në Prishtinë.





Vajzat e bronzta të botës

31 tetor 2023 – Vajzat e karatesë shkruan historinë, duke fituar medaljen e bronzë të botës në disiplinën ekipore të Kampionatit Botëror, të mbajtur në Budapest të Hungarisë.

Ekipi në përbërje: Fortesa Orana, Vlora Qerimi, Hatixhe Zejnullahu e Albulena Gërvalla, të udhëhequra nga trajneri Alban Beqiri, shënuan tri fitore, duke mundur Anglinë, Zvicrën, Francën dhe për të bronzën Kazakistanin. Humbje kishin pësuar ndaj Japonisë.

Pas suksesit, ekipi është pritur edhe nga drejtuesit e KOK-ut, presidenti

Ismeti Krasniqi dhe nënpresidentët Gazmend Maxhuni e Milaim Kelmendi, të cilët përgëzuan vajzat për suksesin.

Në emër të ekipit, sekretari i përgjithshëm i Federatës së Karatesë së Kosovës, Nazmi Gashi, falënderoi drejtuesit e KOK-ut për mbështetjen e vazhdueshme, duke thënë se sukcesi i arritur erdhi pas një konkurrence tejet të fortë, ku u përballën me shtete që kanë lënë gjurmë jo vetëm në Kampionate Botërore, por edhe në Lojërat Olimpikë Tokio 2020.




The Bronze Girls of the World

October 31, 2023 - A team of female karate athletes made history by securing a bronze medal in the team discipline at the World Championship in Budapest, Hungary.

The team, consisting of Fortesa Orana, Vlera Qerimi, Hatixhe Zejnullahu, and Albulena Gërvalla, under the guidance of their coach Alban Beqiri, triumphed over England, Switzerland, France, and Kazakhstan to clinch the bronze. Their journey was marked by a single defeat against Japan.





Bujar Shabani

Krahas ekipit olimpik të Kosovës, Lojërat Olimpik Paris 2024 do të kenë edhe një tjetër përfaqësues nga vendi ynë. Është Bujar Shabani, ortopedi i përzgjedhur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC), për t'i shërbyer sportistëve olimpistë nga e mbarë bota gjatë Lojërave Olimpik Paris 2024.

Bujari, falë edhe mbështetjes së KOK-it, ka përfunduar shkollën sportive, të vetmen të akredituar nga IOC për t'u përzgjedhur më pas si mjek sportiv në spitalin olimpik, që ndodhet në Fshatin Olimpik në Paris 2024. Në intervistën për revistën Olimpi, Bujari rrëfen rrugëtimin e tij të gjatë deri tek arritja e një prej synimeve të mëdha të karrierës së tij.

Kush është Bujari?

Fakultetin e Mjekësisë e kam përfunduar në Universitetin e Prishtinës, specializimin e kam filluar në Lyon, Francë, derisa gjysmën e fundit e kam përfunduar në Prishtinë, QKUK. Doktoratën e kam përfunduar po ashtu në Lyon, Francë, me tematikë rreth Ligamentit të Kryqëzuar të Përpamë (ACL), që është njëra nga lëndimet më të shpeshta sportive.

Me të përfunduar specializimin fillova punën si ortoped në Klinikën e Ortopedisë - QKUK dhe në Spitalin Otrila. Gjatë periudhës së specializimit dhe si ortoped, kam ndjekur shumë konferenca dhe 'fellowshipe' në gjithë botën.

Vlen të theksohen qëndrimi 3-vjeçar në Lyon (Francë), bursa nga Qeveria Amerikane – 'Fulbright' në njërin nga universitetet më me renome në botë Johns Hopkins University (6 muaj), 'fellowshipi' në Azi (Japoni, Kine,

Qatar) mbështetur nga ISAKOS ("International Society of Arthroscopy, Knee Surgery and Orthopaedic Sports Medicine"), 'fellowshipi' në SHBA ("Sacramento, New York, Boston, New Mexico") po ashtu mbështetur nga ISAKOS, 'fellowshipi' në Europe (11 qendrat më të njohura për kirurgji të nyjës së gjurit) mbështetur nga EKS (European Knee Society) etj. E gjithë kjo përvojë më ka shërbyer shumë që sot pacientëve në Kosovë t'ua ofroj shërbimet më cilësore të mundshme në vendin tonë. Po ashtu, duke iu falënderuar kësaj përvoje, kemi sjell risi në Klinikën e Ortopedisë dhe disa operacione janë kryer për herë të parë.

Çka ju lidh me sportin?

Dashuria me sportin më lidh nga fëmijëria. Babai im i ndërë ka qenë dashamirës i madh i sportit, sidomos futbollit. Unë gjatë rritjes kam ndjekur pothuajse secilën lojë në Ligën e Kosovës me të. Edhe pasi u bëra mjek, doja që të isha pjesë e sportit. Kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore që unë kam zgjedhur si fushë veprimi Ortopedinë. Kjo më ka mundësuar që të jem sa më afër me sportistët.

Si erdhi ideja që të aplikoni për të qenë ortoped gjatë Lojërave Olimpik Paris 2024?

Në vitin 2022 kam përfunduar shkollën sportive, e vetmja e akredituar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC). Këtu ka lindur ideja, fillimisht që të jem pjesë e Lojërave Olimpik Paris 2024. Përkundër sfidave të shumta drejt këtij suksesi, puna ime, përvoja e lartcekur, ka bërë që të tejkalohen të gjitha këto sfida, përfshirë edhe ato politike dhe unë të jem pjesë e Lojërave Olimpik Paris

Ortopedi që do t'ju shërbejë sportistëve në LO Paris 2024

2024. Vlen të përmendet që unë do të jem pjesë e spitalit olimpik në kuadër të Fshatit Olimpik dhe do të përkujdesem për të gjithë atletët nga e gjithë bota përgjatë Lojërave Olimpik.

Gjatë programit të IOC për Mjekësi Sportive ju ka mbështetur edhe KOK-u?

Po, falënderoj KOK-un për mbështetje gjatë kryerjes së shkollës sportive. Shkolla në fjalë ka qenë me bazë në Skoci, mirëpo janë organizuar shumë punëtori (workshope) nëpër vende të ndryshme të Evropës. Kësisoj, shpenzimet kanë qenë të larta dhe bursa e dhënë nga KOK-u më ka ndihmuar në këtë drejtim.

Çka do të thotë për ty të fitosh të drejtën për t'iu shërbyer olimpistëve nga mbarë bota në ngjarjen më të madhe sportive në botë?

Kjo do të thotë shumë për mua, sepse do të jem mjeku i parë shqiptar në histori të Lojërave Olimpik, që do të jem me këtë pozitë. Sa do të jetë privilegj, në të njëjtën kohë do të jetë edhe përgjegjësi. Pjesë e stafit mjekësor në këto Lojëra do të jenë mjekët më me renome në botë dhe puna me ta do të jetë përvojë e jashtëzakonshme për mua. Kjo do të thotë shumë edhe për shtetin tonë, sepse nga pak ortoped që do të jenë atje, njëri nga ta do të jetë nga Kosova. Po ashtu, përvojën time nga kjo ngjarje do ta përcjelli në vendin tonë dhe gjithashtu është hapur rruga edhe për mjekët tjerë që dëshirojnë të jenë pjesë e kësaj ngjarje sportive madhështore.

(K.Krasniqi)



Kosovar Orthopaedist to serve World athletes at Olympic Hospital in Paris 2024

In addition to Kosovo's Olympic team, the Paris 2024 Olympic Games will feature another representative from our country - orthopaedist Bujar Shabani.

He has been selected by the International Olympic Committee (IOC) to serve athletes from around the world at the Olympic hospital during the 2024 Paris Olympics.

Thanks to support from the National Olympic Committee, Bujar completed the sports medicine school - the only one accredited by the IOC to later select sports doctors for the Olympic hospital located in the Olympic Village in Paris 2024.

In an interview for the magazine 'Olimpi', Bujar recounts his long journey towards achieving one of the major goals of his career.

KOSOVO



PARIS 2024



Kosova në Paris 2024!

2024-ta njihet edhe si vit olimpik, ku kryeqyteti i Francës, Paris, do të mirëpres edicionin e 33-të të Lojërave Olimpikë Verore.

Për ekipin tonë olimpik do të jetë pjesëmarrja e tretë pas debutimit të artë në Rio 2016 dhe shkëlqimit të dyfishtë në Tokio 2020.

Kur kanë mbetur edhe disa muaj deri në Paris, KOK ndodhet brenda pesë normave olimpikë, të gjitha nga xhudoja, por që zyrtarisht nuk e ka të konfirmuar asnjë. Normat në xhudo konfirmohen në fund të muajit qershor 2024.

Në sportet tjera, pritshmëritë për normë janë kryesisht tek boksi, e konkretisht tek Donjeta Sadiku dhe Shpetim Bajoku, të cilët i presin dy turne kualifikues botëror. Sportet tjera, fatkeqësisht mbeten ende larg arritjes së normës, përkundër se 22 sportistë mbështeten me bursa olimpikë nga KOK.

Për dallim nga Tokio 2020, ku kishim 11 sportistë, gjashtë me normë e pesë me ftesë të univerzalitetit dhe komisionit tre palësh (IOC, ASOIF dhe ANOC), këtë herë numri i sportistëve pritet të jetë më i vogël.

Kosovo in Paris 2024!

The year 2024 is set to be an Olympic year, with the 33rd Summer Olympic Games taking place in Paris, France. This will mark the third participation of our Olympic team, following a golden debut in Rio 2016 and a double brilliance in Tokyo 2020.

With just a few months left until Paris, the Kosovo Olympic Committee (KOC) is within five Olympic norms, all in judo, although none have been officially confirmed yet. The judo norms will be confirmed at the end of June 2024.

In other sports, expectations for norms are mainly in boxing, specifically for Donjeta Sadiku and Shpetim Bajoku, who are awaiting two world qualifying tournaments. Unfortunately, other sports remain far from achieving the norm, despite 22 athletes being supported by Olympic scholarships from the KOC.

Unlike Tokyo 2020, where we had 11 athletes, six with norms and five with universality invitations and tripartite commission (IOC, ASOIF, and ANOC), this time the number of athletes is expected to be smaller.

The tripartite commission, where we last had two invitations (boxing and sport shooting), no longer considers our team small. On the contrary, it deems it



Komisioni tre palësh, ku herën e fundit kishim dy ftesa (boks dhe shenjëtari sportive), nuk e konsideron më ekipin tonë të vogël, përkundrazi e vlerëson të suksesshëm, bazuar në tri medaljet e arta olimpikë dhe numrin e pjesëmarrjes së sportistëve në Rio dhe Tokyo, andaj edhe ka vendosur që Kosova të mos jetë më në listën e shteteve të vogla dhe përfutuese të ftesave të tilla.

Bazuar në pesë normat e xhudos, Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Laura Fazliu, Akil Gjakova e Lorianana Kuka, mbase një nga boksi dhe tri ftesa të univerzalitetit për mbretëreshat e sportit, atletikën e notin, ekipi ynë olimpik pritet të përfaqësohet në Paris me nëntë sportistë, një më shumë se në Rio 2016, e dy më pak se në Tokio 2020.

Sidoqoftë, numrat kanë pak rëndësi. Rëndësi ka rezultati dhe podiumi olimpik. Dhe, jo vetëm podiumi, por pjesa më e lartë e tij, aty ku e kemi mësuar rrugën!

Na priftë e mbara në vitin olimpik!

**Kushtrim Krasniqi,
Zëdhënës i KOK-ut**

successful, based on the three Olympic gold medals and the number of athletes participating in Rio and Tokyo. Therefore, it has decided that Kosovo will no longer be on the list of small states and beneficiaries of such invitations.

Based on the five judo norms of Distria Krasniqi, Nora Gjakova, Laura Fazliu, Akil Gjakova, and Lorianana Kuka, perhaps one from boxing, and three universality invitations for the queens of sport, athletics, and swimming, our Olympic team is expected to be represented in Paris by nine athletes, one more than in Rio 2016, and two less than in Tokyo 2020.

However, the numbers matter little. What matters is the result and the Olympic podium. And not just the podium, but the highest part of it, where we have learned the way!

We wish you all the best in the Olympic year!

**Kushtrim Krasniqi,
Spokesman of NOC Kosova**



Sophie Sorschag mori lejen nga FIS-i për të 'fluturuar' për Kosovën

Tetor 2023 - Skitarja e kërcimeve me ski, Sophie Sorschag, tani e tutje mund të garojë për Kosovën.

Sorschag, që në janar të këtij viti vendosi të lë Austrinë dhe të garojë për Kosovën në garat ndërkombëtare, është dashur të presë rreth 10 muaj për t'iu dhënë drita e gjelbër nga Federata Ndërkombëtare e Skive (FIS).

Deri tek konfirmimi i FIS-it, është dashur një punë e gjatë insistimesh dhe kërkesash, të bëra nga drejtuesit e KOK-ut, presidentit Ismet Krasniqi e sekretarit të përgjithshëm, Besim Aliti, si dhe kryetari i FSK-së, Milaim Kelmendi.

E lumtur për lëshimin e kodit të FIS-it u shpreh edhe vetë Sorschag. "Jam shumë krenare që mu dha mundësia të përfaqësojë Kosovën në kërcimet me ski në gjithë botën.

Nuk po më pritet të garojë në nivelet më të larta dhe të përfaqësojë vendin që besoi në mua, më dha përkrahje të plotë dhe mundësinë për të ndjekur ëndrrat e mia. Mezi po pres të fluturoj për Kosovën", tha Sophie Sorschag.

Ski jumper Sophie Sorschag will now be competing for Kosovo.

Sorschag, who decided to leave Austria and compete for Kosovo in international competitions in January of this year, had to wait about 10 months to get the green light from the International Ski Federation (ISF).

Sorschag herself expressed happiness over the release of the ISF code.

"I am very proud to have been given the opportunity to represent Kosovo in ski jumping worldwide. I can't wait to compete at the highest levels and represent the country that believed in me, gave me full support, and the opportunity to pursue my dreams. I can hardly wait to fly for Kosovo," said Sophie Sorschag.



Medalisti botëror dhe Evropian që la Suedinë për Kosovën

Në vitin 2022 fitoi medaljen e bronzit të botës për të rinjtë. Në të njëjtin vit u stolis me medaljen e bronzit të Evropës për U-21, ndonëse ishte vetëm 17-vjeçar.

Medalje ka të fituara edhe në gara tjera, por të nivelit më të ulët. Të gjitha këto i ka arritur duke përfaqësuar Suedinë.

Por, që nga ky vit, Bleron Ademi, ka vendosur ta përfaqësojë shtetin e vendlindjes së prindërve të tij, Kosovën. Taekwondisti i ri zgjodhi zemrën dhe që në debutimin e tij me flamurin tonë, u ngjiti në podium. Fitoi medaljen e argjendtë në Kampionatin Evropian U-21, të mbajtur në Bukuresht të Rumanisë, prej 7-10 dhjetor 2023, duke shënuar katër fitore. U ndal vetëm në finale.

Në intervistën për revistën Olimpi, 18-vjeçari flet për karrierën e tij dhe të ardhmen, ku nuk ngurron të përmend

ëndrrën e madhe "Kampion olimpik si Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova e Distria Krasniqi".

Kush është Bleron Ademi?

Jam lindur në Baerum të Norvegjisë, dhe pas dy vitesh jemi transferuar me familjen në Trollhatan të Suedisë, ku jetoj edhe sot. Me taekwondo merrem prej 12 vitesh, që nga moshën 6-vjeçare.

Dhe pas shumë vitesh përfaqësimi dhe sukseseve me Suedinë, vendosët të garonit për Kosovën.

Po, pasi shokët e mijë nga ekipi i Kosovës në taekwondo më thonin për të garuar për Kosovën, vendosa ta bëjë këtë. Krahas kësaj, e ndjeja se ishte koha të përfaqësojë vendin tim të vërtetë. Për më tepër, ndjeja se Suedia nuk më vlerësonte aq shumë sa Kosova.

Nuk të vlerësonte?

Jo aq sa duhet, edhe pse isha medalist i bronzit të botës (për të rinjtë).

Që në debutimin tuaj me Kosovën, latë gjurmë, duke u ngjitur në podiumin e Evropianit U-21. Si u ndiet me flamurin në krahë?

Ishte një ëndërr e realizuar, më bëri edhe më të motivuar për të performuar mirë dhe për të fituar medalje.

Synimet tuaja?


Synimet e mia për të ardhmen janë të vazhdoj të fitoj medalje në kampionate të rëndësishme dhe t'u hap dyert të gjithë sportistëve të tjerë të taekwondo-së shqiptare. Por, ëndrra ime më e madhe është sigurisht që të fitoj medaljen e artë olimpikë për Kosovën, ashtu si Majlinda, Distria dhe Nora.

(K.K.)

In 2022, at the tender age of 17, Bleron Ademi made his mark in the world of taekwondo by winning a bronze medal at the World Youth Championship and another at the European U-21 Championship. These achievements, along with other victories at lower-level competitions, were accomplished while representing Sweden.

However, this year, Ademi has chosen to represent Kosovo, the birthplace of his parents. In his debut performance under the Kosovo flag, the young Taekwondo athlete ascended to the podium, winning a silver medal at the European U-21 Championship held in Bucharest, Romania, from December 7-10, 2023. He recorded four victories, only falling short in the final.

In an interview with Olimpi magazine, the 18-year-old discussed his career and future aspirations. He did not hesitate to express his ultimate dream: to become an Olympic champion like Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, and Distria Krasniqi.





Katër medalje evropiane për ekipin e xhudos

Nëntor 2023 - Ekipi i xhudos është kthyer me katër medalje evropiane nga Kampionati Evropian, i mbajtur në Montpellier të Francës.

Distria Krasniqi fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë -52 kilogramë, ndërsa me të bronztën u stolisën, Nora Gjakova (-57 kg), Laura Fazliu (-63 kg) dhe Akil Gjakova (-73 kg).

Loriana Kuka dhe Flaka Loxha e mbyllën Evropianin me nga një fitore të realizuar.

"Fiks katër medalje ne Evropian! Sa e madhe Kosova jonë", ka shkruar trajneri Driton Kuka në Facebook, pas suksesit madhështor. Me këtë arritje, ekipi i xhudos çoi në 23 numrin total të medaljeve të fituara në Kampionate Evropiane.

Triumfi në Montpellier solli edhe pikë olimpike për Paris 2024, ku për momentin të katër medalistët qëndrojnë brenda normës olimpike.



Kosova ndal gjysmën e medaljeve në Evropianin e Hapur në Prishtinë

Akil Gjakova fitoi të artën, ndërsa Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe Dardan Cena fituan të bronzat në ngjarjen historike, kampionatin e parë të Hapur Evropian, të mbajtur në Prishtinë

Në një atmosferë të zjarrtë, xhudistët tanë ndalën gjysmën e

medaljeve dhe gjysmën e parave, ku shpërblimi total ishte 300 mijë euro, fond ky i ndarë nga MKRS përmes projektit "Kosova shtet i xhudos".

Tifozët iu përgjigjen pozitivisht thirrjes për të mbushur sallën e Pallatit të Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, duke mbështetur fuqishëm xhudistët tanë.





Vajzat ruajnë shkëlqimin e futbollit

Derisa djemtë patën një vit të dështuar sa i përket kualifikimit në EURO 2024, vajzat ruajtën shkëlqimin e futbollit. Kombëtarja A u kualifikua në Ligën B, duke përfunduar në vendin e parë të grupit 5 të Ligës C.

Vajzat tona mundën lanë prapa Bullgarinë, të cilën në ndeshjen e fundit e mundën 5:1 dhe Maqedoninë e Veriut.

Në Ligën A u promovuan edhe vajzat e Kombëtares U-17, të cilat fituan miniturneun kualifikues të Grupit 1 në Ligën B për kualifikimet e Kampionatit Evropian "Suedia 2024".

Tek djemtë u shquan vetëm U-19, që arriti sukses të madh, duke u kualifikuar në raundin elit për kualifikim në Kampionatin Evropian.



Pamje nga gara ndërkombëtare e çiklizmit "Tour of Kosova"

Vajzat U-17 në hendboll ëndërrojnë Botërorin

Kombëtarja U-17 e vajzave në hendboll, gjatë vitit 2024 do të ëndërron të shkruajë historinë.

Ato synojnë të kualifikohen në Kampionatin Botëror përmes IHF Trophy Ndërkontinentale.

Vajzat tona kanë fituar garën IHF Trophy të organizuar nga Federata e Hendbollit të Kosovës për U-17 dhe U-19 në Prishtinë.

Hendbolli mbetet sporti i vetëm ekipor, që deri më tani ka shijuar Kampionatin Botëror, duke u kualifikuar me U-21, vite më parë.





FBAK merr organizimin e Asamblesë së Përgjithshme të UIAA-së

Federatës së Bjeshkatarisë dhe Ngjitjes Sportive të Kosovës (FBNSK), i është besuar organizimi i Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Ndërkombëtare të Bjeshkatarisë dhe Ngjitjes Sportive (UIAA).

Asambleja do të mbahet në vitin 2025.

Vendimi u mor në Asamblenë e Përgjithshme të mbajtur në Trabzon të Turqisë.

"Me një lobim të fortë nga përfaqësuesit (Arianit Nikçi, Teuta Beselica dhe Mrika Nikçi), në një konkurrencë shumë të fortë mes Kosovës, Nepalit dhe ShBA-së, Kosova fitoi!", thuhej në njoftimin e FBNSK.

Federata e Golfit e Kosovës anëtarja e 50-të e Federatës Evropiane të Golfit

Federata e Golfit e Kosovës u bë anëtarja e 50-të e Federatës Evropiane të Golfit (EGA).

Vendimi u mor nga shumica absolute e shteteve evropiane gjatë Asamblesë së Përgjithshme të mbajtur më 18 nëntor 2023 në Londër.

"Nga sot fillon një etapë e re e historisë së golfit të Kosovës dhe nga viti i ardhshëm Kosova do jetë pjesëmarrëse në garat evropiane të golfit", shkroi FGK në Facebook.

Synim i Federatës së Golfit të Kosovës është anëtarësimi në Federatën Botërore të Golfit (IGF) dhe në Klubin Mbretëror të Vjetër në Skoci (R&A).

Këto anëtarësime pritet të bëhen deri në shtator të 2024-tës. Federata e Golfit e Kosovës është themeluar më 17 tetor të vitit 2018.



Lonisa Reka, e ardhmja e mundjes

Sporti i mundjes tek ne duket se ka të ardhme të ndritur.

Lonisa Reka është sportisja e re, e cila premtion në të ardhmen.

Mundësja jonë, gjatë vitit 2023 arriti suksesin më të madh në karrierë, duke u renditur e pesta në Kampionatin Botëror U-17, kategoria -49 kg.

Reka është edhe kampione e Ballkanit për U-17, medalje që e fitoi në Serres të Greqisë gjatë vitit 2023.



Kosova e mbyll vitin në vendin e 8-të në botë

Kombëtarja e Kosovës në paragllajdzëm e mbylli vitin në vendin e tetë të renditjes së përgjithshme botërore (WPRS), disiplina paragllajdzëm precizion.

Ekipi ynë përbëhet nga pilotët: Fanol Shala, Eduard Daci, Veton Sylaj, Migjen Shala dhe Gëzim Statovci, ndërsa menaxher, Avni Kuçi. Kosova ka grumbulluar 878.2 pikë.





KOK iu bashkua Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas”

Nëntor 2023 - KOK përmes komisionit “Femra dhe Sporti” dhe në bashkëpunim me projektin “Be Active”, organizoi aktivitetet në kuadër të “16 ditë të aktivizimit – fushata ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas”.


Aktiviteti këtë herë ishte më relaksues, ku mbledhi vajza dhe gra të federatave të ndryshme sportive dhe jo vetëm, të cilat nën moton “Be a hero” (Bëhu hero), praktikuan vallëzimin “Zumba”, që u udhëhoq nga trajnerja Cansu Merve Bakkal nga Turqia.

Në fjalën hyrëse, presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, theksoi se aktiviteti ka për qëllim të frymëzojë vajzat dhe gratë për t’u marrë me aktivitete sportive dhe t’i tejkalojnë paragjykimet se sporti apo sportet e caktuara janë vetëm për meshkujt, duke përmendur edhe sukseset e mëdha, që kryesisht na vijnë nga heroinat tona.

Për rëndësinë e aktiviteteve të tilla dhe të qenit aktiv, foli edhe koordinatori nacional i “Be Active” për Kosovë, Ibër Alaj.

Për aktivitetin e zhvilluar në Hotel Swiss Diamond, por edhe organizimet tjera të realizuara nga komisioni “Femra dhe Sporti”, folën anëtarët e këtij komisioni, Vjollca Krasniqi dhe Besire Domaniku, njëherit anëtare të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut.


Në fund të aktivitetit, pjesëmarrëset patën mundësinë e dhënies së mesazheve frymëzuese dhe motivuese për vajzat dhe gratë. I pranishëm ishte edhe drejtori i sponsorit tonë më të madh, BKT Kosova, Suat Bakkal.





HOTEL SIRIUS

 [siriushotels](#)



BËHU

1%

E ÇDO PAGESE PËR
HERONJTË TANË



HERO!



* 1% e çdo pagese, mbulohet nga BKT Ko

